



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 3395/prot.

Himarë, më 21.07.2023

PROJEKTVENDIM

Nr. 27, datë 21.07.2023

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NR.3252 PROT., DATË 13.07.2023, TË PROTOKKOLIT TONË, DHE NR.5946 PROT., DATË 14.07.2022, TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, LIDHUR MIDIS BASHKISË HIMARË, BASHKISË VLORË, BASHKISË SELENICË DHE MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË , ME OBJEKT : “ MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE” ”

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, nenit 54, shkronja “a” të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, nenit 12 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, VKM-së nr. 431, datë 11.7.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve” dhe VKM-së nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Himarë nr.26, datë 27.05.2022 “Për dhënin e miratimit për riorganizimin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Himarë”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

V E N D O S A :

1. Të miratoj marrëveshjen nr.3252 prot., datë 13.07.2023 të protokollit tonë dhe nr.5946 prot., datë 14.07.2022 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur midis Bashkisë Himarë, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Selenicë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë , me objekt : “Marrëveshje për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve” ”
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Kryetari i Bashkisë Himarë dhe Shoqëria Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Himarë”.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

DREJTORIA JURIDIKE

DREJTORI

Klejli Muharremi

KRYETARI I BASHKISË

Jorgo Goro





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 3395/prot.
2

Himarë, më 21.07.2023

RELACION MBËSHTETËS PËR PROJEKTVENDIMIN

“PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NR.3252 PROT., DATË 13.07.2023, TË PROTOKKOLIT TONË, DHE NR.5946 PROT., DATË 14.07.2022, TË MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË, LIDHUR MIDIS BASHKISË HIMARË, BASHKISË VLORË, BASHKISË SELENICË DHE MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË , ME OBJEKT : “ MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE”

Të nderuar,

Më datë 12.05.2022, me botimit në “Fletoren zyrtare”, ka hyrë në fuqi Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Në këtë vendim parashikohet një riorganizim tërësor i sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura.

Qëllimi i këtij riorganizimi, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, është:

- Të përmirësojë sigurimin e furnizimit me ujë dhe të shërbimeve të kanalizimeve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke plotësuar nevojat e një ekonomie në zhvillim, si dhe duke mbrojtur mjedisin, shëndetin e sigurinë e qytetarëve.
- Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimet duhet të jenë ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht të qëndrueshme përmes mbulimit të plotë të kostos.
- Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimet ofron qasje universale, që i plotëson të gjitha kërkesat rregullatore/evropiane, sipas parimit “ndotësi paguan”.
- Shoqëritë e furnizimit me ujë dhe kanalizimet të kenë efikasitet dhe performancë të cilësisë së shërbimit të barabartë me praktikën e mirë evropiane.
- Ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët të sigurohet me një çmim të përballueshëm.
- Të sigurohet pjesëmarrja e publikut dhe transparenca në politikat e ujit.
- Për të realizuar krijimin e një sektori të furnizimit me ujë sipas standardeve evropiane vlerësohet krijimi i subjekteve me kompetenca të përbashkëta, në përputhje me legjisacionin në fuqi dhe sipas hartës së shoqërive UK të reja, të përcaktuar në lidhjen nr.4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", parshikon që ky riorganizimi të bëhet si më poshtë:

- Për kryerjen e funksioneve në dobi të përbashkët dhe përmirësimin e cilësisë të shërbimeve të ofruara në sektorin e furnizimit me ujë, si dhe largimit, trajtimit e përpunimit të ujërave të ndotura, dy ose më shumë njësi të vetëqeverisjes vendore, brenda një qarku apo midis qarqeve të ndryshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, nenin 14 të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, mund të lidhin marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre dhe me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve.

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore që bien dakord për riorganizimin e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, që ushtrojnë veprimtarinë brenda kufijve të juridiksionit territorial të tyre, nënshkruajnë marrëveshjen e bashkëpunimit me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, sipas formatit tip të përcaktuar në lidhjen nr.1, që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura".

- Shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, pas nënshkrimit dhe hyrjes në fuqi të marrëveshjes së bashkëpunimit, sipas përcaktimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", riorganizohen si subjekte me kompetenca të përbashkëta (në vijim, SKP), të cilat janë shoqëri të reja aksionare të krijuara sipas sistemit të administrimit me dy nivele, në përputhje me formatin e statutin tip, të përcaktuar në lidhjen nr.2, që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", si dhe legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Në momentin e krijimit, SKP-së i transferohen të gjitha të drejtat, detyrimet, si dhe veprimtaria ekonomike e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi të njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Marrëveshja hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e prefektit të qarkut/prefektëve të qarqeve, sipas kërkesave të nenit 14, të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar.

- Kur njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin për të krijuar shoqërinë aksionare me aksionar edhe ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë, ministria zotëron jo më pak se 51 (pesëdhjetë e një) % të aksioneve me të drejta vote. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat kanë lidhur marrëveshje për riorganizimin e shoqërive aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve në pronësi të tyre, zotërojnë bashkërisht jo më shumë se 49 (dyzet e nëntë) % të aksioneve me të drejta vote të SKP-së së krijuar rishtazi, në përpjesëtim me numrin total të abonentëve aktivë, që kanë shoqëritë aksionare ekzistuese në pronësi të tyre në momentin e nënshkrimit dhe të hyrjes në fuqi të marrëveshjes për krijimin e SKP-së.

- Kapitali themeltar për secilën nga SKP-të e krijuara është jo më i vogël se 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë. Shlyerja e vlerës së kapitalit të nënshkruar të bëhet sipas marrëveshjes të nënshkruar nga secila prej palëve, në përputhje me statutin, legjislacionin në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, si dhe përqindjen e aksioneve që do të zotërohen prej tyre, sipas parashikimit të dhënë në pikën 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

- Pas themelimit të SKP-ve të krijuara nga riorganizimi, vijohet me transferimin e plotë të veprimtarisë, që aktualisht ushtrohet nga shoqëri publike të ujësjellës-kanalizimeve (transferuesit) të SKP-të e krijuara (marrësit e transferimit). **Transferimi i veprimtarisë do të bazohet mbi një kontratë (akt transferimi) të noterizuar, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, e cili do të nënshkruhet rregullisht ndërmjet palëve (transferuesve dhe marrësit të transferimit) dhe do të regjistrohet në pasqyrat financiare të shoqërive.**

- Shlyerja e vlerës nominale të aksioneve, që do të zotërohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, të kryhet duke njohur investimet në proces, të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale të ardhshme që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në gjithsecilën prej këtyre shoqërive ose nëpërmjet shuarjes me kompensim të detyrimeve që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes ndaj institucioneve të tjera qendrore buxhetore dhe jobuxhetore. Shlyerja e kontributeve nga ministria përgjegjëse për infrastrukturën mund të realizohet edhe nëpërmjet të drejtave të vlerësueshme në para, të tilla si kompensimi i vlerës së detyrimeve që shoqëritë aksionare ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKP-së. Aksionarët do të nënshkruajnë kontratë rritjeje kapitali, që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen e të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas marrëveshjes së krijimit të SKP-së.

- SKP-të e krijuara nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të parashikuara në pikat 1 e 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, respektojnë dhe zbatojnë kontratat e shërbimit të lidhura para krijimit të tyre, detyrimet kontraktore që burojnë nga marrëveshjet e lidhura nga Këshilli i Ministrave, ministritë e linjës dhe institucionet qendrore, si dhe detyrimet kontraktore nga marrëveshjet e lidhura ndërmjet ish-njësive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve financiare ndërkombëtare ose shoqërive kontraktuese përkatëse.

- Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë u akordon SKP-ve, të krijuara në kuadër të riorganizimit me marrëveshje të subjekteve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, fondet e planifikuara për investime nga buxheti i shtetit apo nga institucionet financiare ndërkombëtare, në përputhje me parashikimet e dokumenteve strategjike sektoriale në fuqi.

Riorganizimi i SKP-ve, sipas parashikimeve të VKM-së nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”, ka filluar në vitin 2022 dhe ka vijuar sipas një programi të bashkërenduar ndërmjet njësisë të vetëqeverisjes vendore dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Bazuar në lidhjen nr.4 “Harta territoriale e shoqërisë SKP që krijohen” të VKM-së nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura”, Ministria përgjegjëse për infrastrukturën ka propozuar, bazuar edhe në hartën territoriale të përgatitur nga AKUM, bashkimin e “Ujësjellës Kanalizimeve Himarë” Sh.a me shoqëritë si më poshtë:

Shoqëria Rajonale UK sh.a

Vlorë

Selenicë

Himarë

Me Vendimin e Këshillit Bashkiak Himarë nr.26, datë 27.05.2022 “Për dhënin e miratimit për riorganizimin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Himarë””, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshillit Bashkiak ka dhënë miratimin për riorganizimin e Shoqërisë Aksionare “Ujësjellës Kanalizime Himarë” dhe ka autorizuar Kryetarin Z.Jorgo Goro për nënshkrimin e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Më datë 13.07.2023 është nënshkruar marrëveshja nr.3252 prot., datë 13.07.2023 të protokollit tonë dhe nr.5946 prot., datë 14.07.2022 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur midis Bashkisë Himarë, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Selenicë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë , me objekt : “Marrëveshje për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve”.

Marrëveshjen nr.3252 prot., datë 13.07.2023 të protokollit tonë dhe nr.5946 prot., datë 14.07.2022 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, lidhur midis Bashkisë Himarë, Bashkisë Vlorë, Bashkisë Selenicë dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë , me objekt : “Marrëveshje për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të ujësjellës kanalizimeve””, po Jua paraqesim për miratim.

DREJTORIA JURIDIKE


DREJTORI

Klelli Muharremi





MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË



Dës bëq Vlorë
Nr. 8560 prot
Dt. 13.07.2023

Nr. 1542 prot
Dt. 13.07.2023

H 112
Prot. 5546
Dt. 19.7.2023

1230
4 02 23

MARRËVESHJE PËR KRIJIMIN E SUBJEKTIT TË KOMPETENCAVE TË PËRBASHKËTA TË UJËSJELLËS KANALIZIMEVE

Kjo marrëveshje lidhet sot më datë 19.07.2023 ndërmjet:

Bashkisë Vlorë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Ermal Dredha

Bashkisë Himarë përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Jorgo Goro

Bashkisë Selenicë, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë z. Nertil Bellaj

dhe

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (këtu e me poshtë referuar si MIE) përfaqësuar me autorizim nr. 133 Datë 27/06/2022 nga Z. Klevis Jahaj, këtëj e tutje referuar të gjitha si "Palët".

Meqënëse:

- Duke patur parasysh reformën e ndërmarrë për përmirësimin e performancës së shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe të shërbimit të konsumatorëve;
- Duke qenë të ndërgjegjshëm për nevojën e përmirësimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe grumbullimin e trajtimin e ujrave të ndotura urbane;
- Duke marrë në konsideratë faktin që shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve Vlorë, Himarë dhe Selenicë vazhdojnë të kenë nevojë për mbështetjen e autoriteteve qendrore për përmirësimin e administrimit të aseteve të saj, shëndoshjen e gjendjes së saj financiare dhe sigurimin e burimeve të financimit për investimet e nevojshme në zonat e tyre të shërbimit;
- Në mbështetje të VKM Nr.302 datë 11.05.2022, që autorizon MIE për hyrjen në një marrëveshje specifike me Bashkitë Vlorë, Himarë dhe Selenicë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë.



- Në mbështetje të Vendimit Nr.51 datë 21.07.2022 të Këshillit Bashkiak Vlorë, të Vendimit Nr.26 datë 27.05.2022 të Këshillit Bashkiak Himarë dhe të Vendimit Nr.18 datë 24.02.2022 të Këshillit Bashkiak Selenicë që autorizojnë Kryetarët e Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë, të hyjnë në një marrëveshje specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë;

Palët bien dakort të hyjnë në një marrëveshje me kushtet dhe termat e mëposhtëm:

Neni 1 Baza Ligjore

1. Kjo marrëveshje lidhet në përputhje me:
 - a) Dispozitat e pikës 5 të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar
 - b) Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar
 - c) Ligjin Nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”
 - d) VKM Nr. 302 datë 11.05.2022, “Politika Kombetare Për Riorganizimin e Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit, Trajtimin dhe Përpunimit të Ujrave të Ndotura”

Neni 2 Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka si qëllim krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta të Ujës-jellës - Kanalizimeve (SKP-UK), i cili do të kryejë veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territorin administrativ të Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë të cilat janë palë e kësaj marrëveshjeje, pjesë e të cilës është edhe AKUM.



Neni 3

Forma dhe emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta

1. Palët bien dakort që Subjekti i Kompetencave të Përbashkëta të Ujësjetllës Kanalizimeve do të jetë një shoqëri aksionare e krijuar SKP-UK, tek e cila do të transferohet tërësisht veprimtaria ekonomike e shoqërive ekzistuese të ujësjetllës-kanalizimeve të cilat aktualisht janë në pronësi të Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë,
2. Emri i Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta i krijuar sipas kësaj marrëveshje do të jetë Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë Sh.a.
3. Shoqëria aksionare e krijuar sipas kësaj marrëveshje do të administrohet me dy nivele administrimi. Organet drejtuese të shoqërisë do të krijohen dhe kompozohen sipas dispozitave të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar.
4. Shoqëria do të ketë si statut të saj statutin tip të shoqërive të ujësjetllës-kanalizimeve të miratuar nga Këshilli i Ministrave.

Neni 4

Objekti i SKPUK

1. Objekti i SKPUK-së është kryerja e veprimtarisë së furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujrave të ndotura në zonat e shërbimit që mbulojnë territoret administrative të Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë në përputhje me legjislacionin e sektorit të furnizimit me ujë.
2. Shoqëria e re e krijuar mund të ngarkohet me detyrimin e mbledhjes së një ose më shumë taksave vendore për llogari të bashkive palë në këtë marrëveshje, nëse kjo kërkohet prej tyre.

Neni 5

Afati i SKPUK

Palët bien dakort që SKPUK i krijuar sipas kësaj marrëveshje të krijohet për një periudhë të pacaktuar.

Neni 6

Kontributi i Palëve

1. Kapitali fillestar për Shoqërinë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë Sh.a është në masën 10.000.000 Lekë. Në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr. 9901 datë 14.4.2008, "Për



9. Gjithashtu, si instrument për shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, do të konsiderohet edhe shuarja me kompensim e vlerës së detyrimeve që Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a, Ujësjetllës Kanalizime Himarë sh.a dhe Ujësjetllës Kanalizime Selenicë sh.a kanë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e

SKP-UK, ndaj institucioneve qendrore buxhetore dhe jo buxhetore, deri në masën e pagimit të plotë të 51% të aksioneve të shoqërisë së re.

Neni 7

Procedurat e Transferimit

1. Përfaqësuesit ligjorë të shoqërive Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a, Ujësjetllës Kanalizime Himarë sh.a dhe Ujësjetllës Kanalizime Selenicë sh.a, me propozimin dhe mbështetjen e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetllës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve (AKUM), do të caktojnë ekspertë të pavarur për të vlerësuar dhe asistuar në mënyrë të përbashkët për të gjitha shoqëritë, gjatë procedurave të transferimit të veprimtarisë për tek shoqëria e re SKP-UK.
2. Bilanci i transferimit të konsiderohet bilanci i datës 31.12.2022;
3. Data e transferimit efektiv, në të cilën aktivitetet do të konsiderohen të kryera nga Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a do të jetë dita e 45-të nga njoftimi i Drejtorive Tatimore.
4. Veprimtaritë e UK në periudhën nga data e bilancit të transferimit deri në datën e transferimit efektiv do të sjellë si pasojë ndryshimin e balancave të transferimit, të cilat do të rregullohen me efekt në tepricën e transferimit që do të njihet. Pasqyrat financiare do të hartohen në datën e transferimit efektiv dhe për këtë mund të përgatitet një raport i posaçëm për të identifikuar diferencat dhe rregullimin e tyre.
5. Të gjitha shpenzimet e nevojshme për kryerjen e procedurës së themelimit të Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a, shpenzimet e nevojshme për caktimin e ekspertëve si dhe shpenzimeve të transferimit të plotë të veprimtarisë tek shoqëria e re SKP-UK do të përballohen nga buxheti i shtetit. Vlera e shpenzimeve të mësipërme si dhe vlera e shpenzimeve fillestare që do t'i akordohet Shoqërisë Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Vlorë sh.a do të përlllogaritet si kontribut në shlyerjen e vlerës nominale të aksioneve të përftuara nga MIE.
6. Shpenzimet për likuidimin e shoqërive transferuese do të përballohen nga shoqëria e re SKP-UK.



- tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, me qëllim themelimin dhe regjistrimin e shoqërive të reja SKP-UK. MIE do të likujdojë vlerën e 51% të aksioneve që do të përfitojnë.
2. Pjesëmarrja në përqindje në asamblenë e aksionereve në shoqërinë e re ujësjellës-kanalizime (SKPUK) e Bashkive Vlorë, Himarë dhe Selenicë, në pronësi të të cilave janë aktualisht shoqëritë ekzistuese të ujësjellës-kanalizimeve është përlogaritur në përpjesëtim me numrin e abonentëve aktive që këto shoqëri kanë duke përfshirë edhe kontratat aktive aktuale që administrohen nga vetë Bashkitë në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes për krijimin e SKPUK, vlera totale e të cilave do të përbejë 49% të aksioneve të shoqërisë së re, dhe përbëhet në përqindje si vijon: Bashkia Vlorë 41.35%, Bashkia Himarë 4.60% dhe Bashkia Selenicë 3.05%.
 3. Pas themelimit të shoqërisë së re SKP-UK, Bashkitë Vlorë, Himarë dhe Selenicë do të transferojnë tek SKP-UK të gjithë veprimtarinë e shoqërive të UK, që kryejnë aktualisht veprimtarinë e furnizimit me ujë dhe largimin, grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në territoret administrative respektive në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”.
 4. Në Bashkitë Vlorë, Himarë dhe Selenicë, ku ka njësi të shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, të cilat nuk kanë qenë të organizuara në formën e shoqërive aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, brenda datës 30 Shtator 2023, janë përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe transferimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.a.
 5. Pasi procesi i transferimit të ketë përfunduar, përcaktimi i vlerës nominale të 51% të aksioneve që do të zotërohen nga MIE, në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.a do të realizohet pasi vlera e saktë e aksioneve të përfituara të përcaktohen në bazë të raportit që do të hartohet nga eksperti kontabël që do të caktohet gjatë procedurave të transferimit.
 6. Aksionerët do të nënshkruajnë kontratë rritje kapitali që investimet e ardhshme dhe fitimi të kapitalizohen dhe të alokohen derisa të arrijnë përqindjen sipas kësaj marrëveshje.
 7. Shlyerja e vlerës nominale të aksioneve që do të zotërohen nga MIE do të kryhet duke njohur investimet në proces të cilat janë financuar nga buxheti i shtetit dhe me anë të investimeve kapitale që qeveria do të ndërmarrë në vitet në vijim në Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Vlorë Sh.a.
 8. Në rastet kur vlera e investimit të parashikuar dhe marrë tashmë përsipër nga qeveria qendrore dhe të pasqyruar në tavanet buxhetore do të kalojë vlerën nominale të 51% të aksioneve, pasqyrimi i vlerës së tepriçës nuk ndryshon masën e pjesëmarrjes në aksione të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Qarku Vlorë sh.a.



Neni 8

Prishja e marrëveshjes në mënyrë të njëanshme

1. Asnjë nga palët nuk mund të prishë këtë marrëveshje në mënyrë të njëanshme pa kaluar 10 vjet nga krijimi i SKPUK-së.
2. Pas kalimit të afatit 10-vjeçar të përcaktuar në pikën 1, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në çdo kohë mund të vendosë tërheqjen e njëanshme nga kjo marrëveshje duke i transferuar aksionet e saj në shoqërinë e krijuar sipas kësaj marrëveshje tek Bashkitë Vlorë, Himarë dhe Selenicë proporcionalisht me përqindjen e aksioneve të tyre në shoqëri.
3. Nëse një nga Bashkitë Vlorë, Himarë dhe Selenicë kërkon prishjen e njëanshme të kësaj marrëveshje pas kalimit të afatit 10-vjeçar, bashkia duhet të ndër marrë hapat e kërkuara në përputhje me dispozitat e ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar.
4. Nëse një nga bashkitë vendos të prishë në mënyrë të njëanshme marrëveshjen, sipas pikës "3", ajo është e detyruar që për vitin buxhetor pasardhës të mbulojë të gjitha investimet apo detyrimet e tjera financiare përfshirë masat e miratuara në biznesplanin e shoqërisë së ujësjellës-kanalizimeve.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që do të lindë gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, palët do të përpiqen ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërt secila nga palët mund t'i drejtohet për zgjidhjen e saj Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Neni 10

Të tjera

Gjatë gjithë periudhës tranzitore të transferimit, Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve do të pezullojnë të gjitha planet e investimeve dhe procedurat e prokurimit që kanë aktualisht në proces, përveç mirëmbajtjeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë.



Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e Prefektit/Prefektëve sipas kërkesave të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

Kryetari i Bashkisë Vlorë

Emal Drodhës

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kryetari i Bashkisë Himarë

Haris Gore

Kryetari i Bashkisë Selenicë

Nertil Bellej





Neni 11
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi është nënshkruar rregullisht nga palët dhe është marrë shprehja e ligjshmërisë së marrëveshjes nga ana e Prefektit/Prefektëve sipas kërkesave të nenit 14 të Ligjit Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar.

Kryetari i Bashkisë Vlorë

Ernal Drodhës

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Kryetari i Bashkisë Himarë

Haris Goro

Kryetari i Bashkisë Selenicë

Nertil Bellej





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 261A prot.

Himarë, më 30.05.2022

V E N D I M

Nr. 16 datë 27.05.2022

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR RIORGANIZIMIN E SHOQËRISË AKSIONARE
“UJËSJELLËS KANALIZIME HIMARË”**

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.2, nenit 14, nenit 23 . nenit 54 shkronja “d” dhe shkronja “gj”, nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, nenit 12 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” të ndryshuar, ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” të ndryshuar, VKM-së nr. 431, datë 11.7.2018 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, dhe VKM-së nr.302 , datë 11.05.2022 “ Këshilli Bashkiak Himarë ne mbledhjen e tij te dt: 27.05.2022 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike miratoi me shumicë vote dhe ...

V E N D O S I :

1. Të japë miratimin për riorganizimin e shoqërisë aksionare “Ujësjetës Kanalizime Himarë”, sipas përcaktimeve të VKM-së nr.302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.
2. Të japë miratimin për lidhjen e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimin, trajtimin dhe përpunimin e ujërave të ndotura në zonat e shërbimit, sipas lidhjes nr.4 “ Harta territoriale e shoqërive SKP që krijohen” të VKM-së nr.302 , datë 11.05.2022 “ Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, si më poshtë:

Shoqëria Rajonale UK Vlorë sh.a

Vlorë

Selenicë

Himarë

3. Të japë miratimin që Kryetari i Bashkisë Himarë Z.Jorgo Goro, të përfaqësojë Bashkinë Himarë, në nënshkrimin e marrëveshjes specifike me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta dhe në të gjitha procedurat administrative- ligjore në zbatim të kësaj marrëveshje.
4. Ngarkohet e gjithë struktura organizative në Bashkinë e Himarës dhe Shoqëria Aksionare "Ujësjetllës Kanalizime Himarë" për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për "Vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë.

Kryetari

Dhimitër Kapaj

